

V E N D I M

Nr. 86 Date 17.07. 2008

**PER NDRYSHIMIN E LICENSES SE SHOQERISE “DARDANIA ENERGJI”
SH.P.K**


Në mbështetje të neneve 9 dhe 19, të Ligjit 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, te ndryshuar, nenit 15 të “Rregullores për Procedurat e Licensimit” të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.21 datë 04.04.2007, dhe Vendimit të Bordit të Komisionereve nr.42 date 11.04.2008 “Për fillimin e procedurave për modifikimin e licenses për prodhimin e energjise elektrike me Nr.10 seria PV03P” , Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 17.07.2008, mbasi shqyrtoi kërkesen e shoqerise En – Ku sh.p.k, për ndryshimin e licenses për prodhimin e energjise elektrike me Nr 10, Seria PV03P, leshuar me vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s nr.20 date 19.12.2003 shoqerise Dardania Energji sh.p.k, dhe konstatoi paraqitjen e plote nga shoqeria “EN- KU” sh.p.k , të dokumentacionit të kërkuar nga ERE, si dhe shprehjen juridikisht të vullnetit të shoqerise “Dardania Energji” sh.p.k, për kryerjen e ndryshimeve në licensen e leshuar kësaj shoqerie,

Vendosi

1. Të miratoj kërkesen e shoqerise En – Ku sh.p.k për ndryshimin e licenses Nr.10 seria PV03P, leshuar me Vendimin e Bordit të Komisionereve nr.20, date 19.12.2003 shoqerise Dardania Energji sh.p.k.
2. Në licensen me Nr. 10 seria PV 03P, në pjesët ku përcaktohet subjekti të cilit i jepet Licensa ndryshohet subjekti Dardania Energji sh.p.k dhe vendoset emertimi i subjektit EN- KU sh.p.k si dhe të dhënat e kësaj shoqerie lidhur me Kodin Fiskal dhe Certifikatën e Rregjistrimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I
SEKTORIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE
Bordi i Komisionereve




3. Kudo ku ne license percaktohet Dardania Energji sh.p.k si mbajtes i licenses pjeset e licenses shfuqizohen dhe hyjne ne fuqi ndryshimet sipas pikes 1 te ketij vendimi.
4. Ne pjeset e licenses se dhene shoqerise Dardania Energji sh.p.k, ku percaktohen data e hyrjes ne fuqi te licenses, ne vazhdim te numrit te vendimit te percaktuar ne licensen nr. 10, Seria PV03P shenohen edhe ndryshimet e ketij vendimi si pasoje e vendimmarrjes se Bordit te Komisionereve te ERE-s me date 17/07/2008.
5. Shoqerise EN- KU sh.p.k ti leshohet licensa me permbajtjen e ndryshuar sic percaktohet ne kete vendim.
6. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut te njoftoje shoqerite Dardania Energji sh.p.k dhe EN-KU sh.p.k per vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I
SEKTORIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE
Bordi i Komisionereve



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. __ date 17.07.2008

PER NDRYSHIMIN E LICENSES SE SHOQERISE "DARDANIA ENERGJI"
SH.P.K

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____